



Pranuar / Dorezuar Received/ Delivered	01-09-2023	3	viti Year
Organ / Rrjesia Org./Unit	Nr. Prot Pr. Prot Prot No	Shlopje Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	5920/2023		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1038/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas ankesës me numër A.nr.1038/2023 të datës 28.07.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 01.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur më ankesën A.nr.1038/2023 të datës 28.07.2023, të parashtruar nga ankuesi
- II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa në Ministrinë së Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit me numër të protokollit nr.prot: 15 të datës 23.04.2013 në pozitën e punës „Zyrtar i Postës“, më datë 28.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5437/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me heshtjen administrative dhe kategorizimin e pozitës së tij në nivelin Profesional 3.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 31.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa me datë 03.08.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5437/2023 të datës 28.07.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail i datës 15.05.2023; Kërkesë e datës 15.05.2023; Akt Emërimi me numër nr.prot.15 i datës 23.04.2023; E-mail i datës 01.03.2023; Kërkesë e datës 01.03.2023; E-mail i datës 23.01.2023; Kërkesë e datës 23.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ultë dhe profesional i datës 31.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 26.12.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 29.12.2018; ID Kartela me numër MAP-1248; Diplomë me numër 1113-863/22 e datës 30.09.2022; Shkresë me të dhënat bazë për Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 31.07.2023; Përgjigje në ankesë e datës 03.08.2023; Listë e pagave e datës 01.08.2023; Kërkesë për ekuivalentimin e koeficienteve e datës 21.03.2023; E-mail i datës 15.08.2023; E-mailat e datës 16.08.2023; E-mail i datës 31.08.2023; E-mail i datës 01.09.2023.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i provave të lëndës ka gjetur se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, mirëpo sipas Akt Emërimit me numër protokollit Nr.prot.15 të datës 23.04.2023 mban pozitën e punës „Zyrtar i Postës“, ndërsa i njëjti pretendon se ushtron detyrat e „Zyrtarit të Arkivës“. Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit Këshilli ka kërkuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Vendimin për deklarimin e statusit të ankuesit, mirëpo më datë 01.09.2023 Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Brendshme përmes e-mailit zyrtar e ka njoftuar Këshillin se Institucioni e ka dërguar listën e nëpunësve civil dhe deklarimin e statusit të zyrtarëve publik për verifikim në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë mirëpo Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë nuk ka ofruar asnjë lloj konfirmimi apo vendimi lidhur me miratimin e deklarimit/rregullimit të statusit të zyrtarëve Publikë të MPB-së, andaj edhe për sa i përket pozitës së ankuesit nuk ka ndonjë vendim lidhur me deklarimin e pozitës se tij.

Bazuar në dispozitat e Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht me nenin 2 është përcaktuar se; „...2.Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës.... 6. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike. Ndërsa me nenin 82 po të këtij ligji është përcaktuar se “ Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në nenet 79 deri 81 të këtij ligji, marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës” rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në Kontratën e Punës me numër Nr.01-112-187952 të datës 29.12.2016, Kolegji i Këshillit konstatoi se pozita “Shpërndarës Poste”, hynë në kategorinë e nëpunësve “Administrativ-Teknik dhe Mbështetës”.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenit 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, thekson së nëpunësi administrativ-teknik dhe mbështetës fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në Gjykatën kompetente.

Në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetues së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e

nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, andaj pas konstatimi së ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji i Këshillit vlerëson së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent që të shqyrtoj ankesat lidhur me kontestet e marrëdhënies së punës të nëpunësve "Administrativ-Teknik dhe Mbështetës", andaj mbi këtë bazë Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën parashtruar nga ankuesi

Marr parasysh konstatimin si me lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër protokolli 5437/2023 të datës 28.07.2023, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesi nuk ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që lënda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa të Komunës së Pejës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1038/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

[Signature]
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Komisionit për Ankesa në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivot të KPMSHCK- së;

